



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 23.09.2026

**MBLEDHJA Nr. 43,
Datë 25.09.2026, ora 12:30
e Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 59/2026, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 25.09.2026, ora 12:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 43 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi kërkesën e shoqërisë “EUROTECH INNOVATION” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “EURON SOLAR-PV” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “GSA” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës.
5. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale në përmbajtjen e faturave të energjisë elektrike dhe informacionin e faturimit”.
6. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”.
7. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI
Petrit AHMETI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTARE E BORDIT
Erjola SADUSHI**